REPUBLIKA E KOSOVËS

ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 21.16.1-2015-08

RAPORTI I AUDITIMIT

PËR PASQYRAT FINANCIARE TË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2015

Prishtinë, qershor 2016

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për t'u kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne po rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe po luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Ibrahim Gjylderen, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinioni i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Valbon Bytyqi, i mbështetur nga Udhëheqësja e ekipit, Shehrije Shala dhe Anëtaret e ekipit, Ajtene Llapashtica dhe Burbuqe Idrizi.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme 4

1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm 6

2 Qeverisja 9

3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli 14

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit 33

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP 34

Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak 37


Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare të Ministrisë së Punëve të Brendshme për vitin 2015 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderojmë Ministrin dhe ekipin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2015 u ndërmor në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të auditimit në Sektorit Publik (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e datës 15/12/2015.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën I):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2015 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinioni

Shtojca II shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm. Opinioni i Auditorit të Përgjithshëm është:

<u>Opinion i pamodifikuar</u>

Pasqyrat financiare *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Formulimi i plotë i fjalëve është dhënë në hollësi në Pjesën 1.2 të këtij raporti.

Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:

Procesi i vetvlerësimit dhe përgjigja ndaj rekomandimeve të vitit paraprak nuk po adresohen ashtu siç kërkohet për zhvillimin dhe përmirësimin e organizatës.	Ministri duhet ta zbatojë një proces rigoroz për të siguruar që procesi i vetvlerësimit dhe rekomandimet e vitit paraprak adresohen në mënyrë aktive ku çështjet/progreset kyçe i raportohen menaxhmentit në baza mujore (shih çështjet 1 dhe 2).
Ministria e Punëve të Brendshme, ka lidhë marrëveshje për shërbime të veçanta me pesë të punësuar pa procedura paraprake të rekrutimit. Pagesat e tyre ishin bërë nga buxheti për mallra dhe shërbime.	Ministri duhet të sigurojë se janë marrë masa për të ndërprerë lidhjen e kontratave pa procedura të rekrutimit, si dhe të sigurojnë se në buxhetin e viteve në vijim në kategorinë paga dhe mëditje të përfshihen pagat e të gjithë të punësuarve të nevojshëm (shih çështjet 8).
Numri i pozitave më ushtures detyre, ende i lartë. Në Ministrinë e Punëve të Brendshme ishin 19 pozita, ndërsa në Policinë e Kosovës në fund të vitit ishin 24 pozita.	Ministri duhet të sigurojë se është adresuar rekomandimi i lidhur më menaxhimin e procedurave të rekrutimit. Procedurat e rekrutimit duhet të fillojnë me kohë, dhe kohëzgjatja e funksionit si ushtrues detyre të mos jetë më e gjatë se periudha e përcaktuar më Udhëzimin Administrativ (shih çështjen 9).
Në mungesë të pjesëve rezervë, dhe numrit të vogël të stafit në Flotën e Policisë edhe më tutje presin për servisim 131 automjete, ose rreth 10% të gjithsej automjeteve. Ato janë në pritje qysh nga viti 2012 e tutje.	Ministri në bashkëpunim më Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Kosovës duhet të vazhdojnë përpjekjet për të përmirësuar menaxhimin e servisimit dhe mirëmabjtës së automjeteve në Flotën e Policisë. Kontrollet duhet të përfshijnë procesin prej identifikimit të defekteve e deri te riparimi i tyre, për të eliminuar pritjet e gjata të automjeteve dhe shfrytëzimin efikas të tyre (shih çështjen 13).

Përgjigja e Ministrit – auditimi 2015

Ministri ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet e dhëna.

1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

1.1 Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF) të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuara në PVF. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata për prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PVF-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.2 Opinioni i Auditimit

Opinioni i pamodifikuar

Ne kemi audituar PVF-të e MPB-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale, shënimet shpjeguese të PVF-ve si dhe shpalosjet.

Sipas mendimit tonë PVF-të prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale të pranimeve dhe pagesave, si dhe të buxhetit të realizuar të MPB-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullën financiare të MF, nr. 03/2013 për PVF-të e organizatave buxhetore.

Baza për Opinionin

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e PVF-ve. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të PVF-ve të organizatave Buxhetore në Kosovë, ZAP është i pavarur nga MPB dhe përgjegjësitë tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë.

Përgjegjësia e Menaxhmentit dhe personave përgjegjës për Qeverisje dhe PVF-të

Sekretari i Përgjithshëm i MPB-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të PVF-ve sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrolle të brendshme të tilla të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e PVF-ve pa keqdeklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PVF-ve

Përgjegjësia jonë është që ta shprehim një opinion për PVF-të në bazë të auditimit tonë. Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike, ta planifikojmë dhe ta kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për atë nëse PVF-të nuk kanë keqdeklarime materiale.

Objektivat tona janë që të marrim siguri të arsyeshme nëse PVF-të në tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë gjithnjë një keqdeklarim material kur ajo ekziston. Keqdeklarimet mund të lindin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato mund të pritet që të ndikojnë vendimet e përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre PVF-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe shpalosjeve në PVF. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në PVF, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori e konsideron kontrollin e brendshëm që është relevant në PVF-ve nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Auditimi e përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të PVF-ve.

1.3 Pajtueshmëria me kërkesat për PVF dhe kërkesat tjera për raportim

MPB kërkohet të veproj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194.
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve; dhe
- Kërkesat e procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);

Marrë parasysh çka u tha më lart, Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF, me rastin e dorëzimit të draft PVF-ve në Qeveri, mund të konsiderohet e saktë dhe e drejtë.

Në kontekst të PVF-ve, ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me këto kërkesa.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime lidhur me PVF-të.

2 Qeverisja

2.1 Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për MPB-në që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vetvlerësimit që plotësohet nga të gjitha organizatat buxhetore siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një organizatë individuale buxhetore të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse. Prandaj, ne e kemi aplikuar një qasje konsistente në të gjitha auditimet për ta përcaktuar cilësinë e listave kontrolluese të plotësuara për vetvlerësim dhe për ta vlerësuar saktësinë e gjendjes së paraqitur mbi qeverisjen në Kosovë.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes e pasqyron një shqyrtim të:

- Fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku ne besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- Fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuara përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij raporti).

2.2 Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Në raport me vitin e kaluar, menaxhmenti i MPB-së kishte bërë përmirësime në aranzhimet e qeverisjes së mirë. Raportimi ishte në nivel të duhur. Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara. Agjencitë Ekzekutive kanë strukturën e tyre organizative, menaxhuese dhe llogaridhënëse. Këto janë përgjegjëse për raportim, ku janë përcaktuar qartë si dhe janë aplikuar mënyrat dhe proceset e llogaridhënies dhe raportimit.

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) kishte realizuar disa raporte të auditimit për menaxhmentin. Ato ofruan një pasqyrë të qartë mbi nivelin e sigurisë së kontrolleve të brendshme dhe efektivitetin e tyre.

Megjithatë, proceset qeverisëse duhet të përmirësohen edhe më tej, për të mbështetur menaxhimin efektiv të aktiviteteve të Ministrisë. Adresimi i rekomandimeve nuk ishte i kënaqshëm. Nga 11 rekomandimet e dhëna vetëm tri prej tyre janë implementuar plotësisht. Kjo paraqet një sfidë për adresimin e plotë të të gjitha rekomandimeve.

Dobësi kishte edhe në identifikimin dhe menaxhimin e rrezikut, për të identifikuar pengesat e mundshme krahas përmbushjes së objektivave. Kjo reflekton mungesë të llogaridhënies tek menaxhmenti i lartë lidhur me menaxhimin e regjistrit të rreziqeve si dhe një mungesë njohurie brenda agjencive dhe departamenteve për rolet e tyre në ofrimin e mbështetjes për procesin e menaxhimit të rrezikut.

2.3 Rekomandimet e vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2014 të MPB-së ka rezultuar me 11 rekomandime kryesore. MPB kishte përgatitur një plan veprimi ku paraqitet mënyra se si do të implementohen të gjitha rekomandimet.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2015, tri rekomandime janë implementuar, gjashtë janë adresuar pjesërisht, ndërsa dy nuk janë adresuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

Çështja 1 – Nivel i ulët i implementimit të rekomandimeve – Prioritet i lartë

E gjetura	Pavarësisht përgatitjes së planit të veprimit për implementimin e rekomandimeve si dhe angazhimit të MPB-së për të adresuar këto çështje, edhe më tutje dy rekomandime kanë mbetur të pa adresuara. Rekomandimet e pa adresuara ndërlidhen me mbulimin e pozitave me ushtrues detyre si dhe me pagesën e të punësuarve nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve. Duke pas parasysh që përpos rekomandimeve të pa adresuara, edhe gjashtë rekomandime të adresuara nuk janë implementuar plotësisht, paraqet një sfidë për MPB-në dhe agjencitë e saj ekzekutive.
Rreziku	Mos implementimi i potë i rekomandimeve nga viti i kaluar ka ndikuar në paraqitjen e dobësive të njëjta të kontrolleve të menaxhmentit dhe kontrolleve të tjera në sisteme kyçe financiare me theks të posaçëm në aktivitetet e menaxhimit të personelit.
Rekomandimi 1	Ministri dhe Drejtoret e Përgjithshëm duhet të sigurojnë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për implementimin e rekomandimeve të bëra nga Auditori i Përgjithshëm (AP), me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.

2.4 Lista kontrolluese e vetvlerësimit të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një listë të detajuar të vetvlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Për të gjitha auditimet e ndërmarra, ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vetvlerësimit të MFK-së të dorëzuara në Ministri, duke vlerësuar nga një pyetje kyçe në secilën komponentë të listës kontrolluese.

MPB ka përmbushur kërkesat e përgjithshme të përcaktuara në listën kontrolluese të vetvlerësimit të përcaktuar nga MF-i, me përjashtim të hartimit të listës së rreziqeve operacionale për vitin 2015 (referoju nënkapitullit 2.5.2. Vlerësimi i rrezikut).

Ne kemi përmbledhur konkluzionet tona për MPB-në të cilat se bashku më të gjeturat dhe konkluzionet e nxjerra në auditimet tjera do të konsolidohen në Raportin tonë Vjetor të Auditimit. Kjo nuk ka për qëllim të jap koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vetvlerësimit por do ta jap gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për t'i mbështetur përpjekjet e MF në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

2.5 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar në planifikimin e auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit MPB operon dhe sfidat me të cilat përballet.

2.5.1 Aranzhimet e llogaridhënies

Në kuadër të MPB-së veprojnë gjashtë Agjenci Ekzekutive si: Policia e Kosovës (PK), Akademia e Kosovës për Siguri Publike (AKSP), Inspektorati i Policisë së Kosovës (IPK), Agjencioni i Kosovës për Forenzik (AKF), Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (AME) si dhe Agjencioni për Regjistrim Civil (ARC).

Tri prej tyre AKF, AME dhe ARC veprojnë në kuadër të buxhetit të MPB-së. Ndërsa PK, AKSP dhe IPK i dorëzojnë PVF-të e tyre në MPB e cila më pas i konsolidon si një tërësi.

Agjencitë Ekzekutive kanë strukturën e tyre organizative, menaxhuese dhe llogaridhënëse. Këto janë përgjegjëse për raportim, ku janë përcaktuar qartë si dhe janë aplikuar mënyrat dhe proceset e llogaridhënies dhe raportimit.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.5.2 Vlerësimi i rrezikut

Të gjitha organizatat buxhetore pritet të zbatojnë vlerësimin e rrezikut. Udhëzimet e përcaktuara në komponenten e 2-të të pyetësorit të vetvlerësimit kërkojnë që regjistri i rrezikut të jetë i kompletuar për të mbështetur menaxhimin efektiv operacional dhe strategjik. Po ashtu, dispozitat e LMFPP-së si dhe Rregulla Financiare e Thesarit nr. 01-2010 përcaktojnë që ZKA është përgjegjës për zbatimin e aranzhimeve, procedurave dhe sistemeve për të siguruar përmbushjen e objektivave kyçe të organizatës dhe për të identifikuar rreziqet drejt arritjes së këtyre objektivave, si dhe për të ndërmarrë hapa për të menaxhuar ato rreziqe.

Përcaktimi i rreziqeve, ndikimi i tyre, veprimet që duhet të ndërmerren dhe përgjegjësia për veprimet, në përgjithësi duhet të dokumentohen në një regjistër rreziku në formën e kërkuar sipas doracakut të MFK-së.

Çështja 2 - Moszbatimi i kërkesave për menaxhimin e rrezikut – Prioritet i lartë

E gjetura MPB së bashku me agjencitë e saj ekzekutive kanë kryer vetvlerësimit sipas rregullave të MFK-së. Mirëpo ende nuk kanë krijuar procedura formale dhe të dokumentuara të identifikimit dhe menaxhimit të rreziqeve që identifikon pengesat e mundshme krahas përmbushjes së objektivave.

Kjo reflekton mungesë të llogaridhënies tek menaxhmenti i lartë lidhur me menaxhimin e regjistrit të rreziqeve si dhe një mungesë njohurie brenda agjencive dhe departamenteve për rolet e tyre në ofrimin e mbështetjes për procesin e menaxhimit të rrezikut. Për menaxhimin efektiv të rrezikut nevojiten veprime të qarta, të cilat duhet të zbatohen për të gjitha rreziqet domethënëse që kanë ndikim tek organizata.

Rreziku Proceset e dobëta për identifikimin e rreziqeve reduktojnë efektivitetin e menaxhimit financiar brenda organizatës buxhetore, duke rezultuar me dobësi në procesin buxhetor si dhe në reduktimin e mundësisë që menaxhmenti të reagojë ndaj sfidave financiare me kohë.

Rekomandimi 2 Ministri dhe Drejtorët e Përgjithshëm të Agjencive duhet të sigurojnë se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek një drejtor përkatës dhe të sigurojnë raportim mujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë dhe për rreziqet që janë duke u menaxhuar.

2.5.3 Raportimi Menaxherial

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Të gjitha agjencitë duke përfshirë PK, IPK dhe AKSP kanë raportuar vazhdimisht dhe kanë mbajtur takime të rregullta dy javore të menaxhmentit në të cilat ishte diskutuar për aktivitetet dhe performancën e përgjithshme të buxhetit. Sipas nevojës ka takime edhe për tema të veçanta që mund të jen takime të përditshme dhe javore. Gjatë analizave sa i përket çështjes së raportimeve kemi vërejtur se është një sistem mirë i zhvilluar i raportimit të brendshëm dhe një monitorim i vazhdueshëm.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

NJAB operon me 11 anëtarë (në MPB Drejtori dhe tre auditor, në PK Drejtori dhe katër auditor, në AKSP një drejtor dhe në IPK një drejtor). Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës të punës i cili reflekton rreziqet financiare dhe ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm.

NJAB-të në MPB, PK, IPK dhe AKSP kishin planifikuar gjithsej 32 auditime për vitin 2015. Gjatë përgatitjes së planit ato janë fokusuar në auditimin e fushave të cilat paraqesin rrezik më të lartë. Mbulimi i auditimeve ishte kryesisht për aktivitetet e vitit aktual. Pas procesit të planifikimit, menaxhmenti ka bërë kërkesë të bëhen edhe katër auditime shtesë për fusha të caktuara.

NJAB-të kishin përmbushur në tërësi planifikimin, përfshirë edhe auditimet më kërkesë të menaxhmentit. Në këto raporte, ishin dhënë 184 rekomandime lidhur me përmirësimin e funksionimit të kontrollit të brendshëm.

Për vitin 2015, Komiteti i Auditimit (KA) kishte mbajtur katër takime. Në këto takime është diskutuar lidhur me adresimin e rekomandimeve të dala nga raportet e auditimit të NJAB-së, si dhe raporti i auditimit të jashtëm për vitin 2014.

KA kishte bërë përcjelljen e implementimit të rekomandimeve për të gjithë agjencitë ekzekutive në kuadër të MPB me një raportim - analizë tre mujore mbi gjendjen e zbatimit të rekomandimeve, përfshirë auditimin e brendshëm dhe të jashtëm. Sipas raportit përmbledhës të KA-së, shohim se nga 184 rekomandimet e dhëna nga auditimi i brendshëm, 100 rekomandime janë implementuar, 82 janë në proces të adresimit apo pjesërisht të adresuara, ndërsa dy nuk janë adresuar.

Ne analizuam në përgjithësi raportet e NJAB-së dhe vlerësuam se raportet ishin cilësore. Ato i ofruan menaxhmentit një pasqyrë të qartë mbi nivelin e sigurisë së kontrolleve të brendshme dhe efektivitetin e tyre.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

3.1 Hyrje

Puna jonë për MFK-në jashtë fushave të Qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve. Si pjesë e kësaj ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

3.2 Konkluzioni për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin

Menaxhimi financiar dhe kontrolli kanë dëshmuar proces relativisht të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit.

Në vitin 2015, MPB ka përdorur afro 99% të buxhet final me një përmirësim prej 4% në raport më vitin paraprak. Të hyrat ishin menaxhuar dhe raportuar në pajtueshmëri me legjislacionin. Megjithëse në raport më vitin 2014 të hyrat vetanake kishin pësuar rënie prej 2,588,699€, si rezultat i vendimit për mos konfiskimin e dokumenteve të udhëtimit. Prokurimi si proces ishte realizuar në përputhje me rregullat e përcaktuar për prokurimin publik, më përjashtim të prokurimit për blerjen e pjesëve rezerve të automjeteve për të cilat kishin përdore procedurat e kuotimit të çmimeve.

Edhe përkundër kontrolleve të identifikuara në fushat e lartcekura, nevojitën veprime shtesë për të përmirësuar menaxhimin financiar dhe kontrollit. Kjo përshinë menaxhimin e shpenzimeve, pasurinë dhe obligimet.

Menaxhimi i pagave nuk ishte bërë në përputhje më Legjislacionin. Një numër i konsiderueshëm i pozitave menaxhohen përmes ushtruesve të detyrave. Pesë të punësuar ishin paguar më kontrata për shërbime të veçanta nga mallrat dhe shërbimet. Vlerësimi i performancës së stafit edhe në vitin 2015 nuk ishte bërë. Kjo shkakton mos identifikimin e fushave të cilat kërkojnë përmirësime të mëtejme.

Sfidë e MPB-së dhe Agjencive ishte edhe fusha e menaxhimit të pasurisë. Te Flota e Policisë ende një numër i konsiderueshëm i automjeteve presin për servisim. Dobësi janë identifikuar edhe në regjistrat e pasurisë (përfshirë regjistrat kontabël dhe regjistrat e pasurisë). Procesi i inventarizimit të PK-së nuk ishte përfunduar para përgatitjes së PVF-ve për të mundësuar identifikimin e mangësive në regjistrat e pasurisë.

Ndërsa nga aspekti i rëndësisë më të ulët, veprime shtesë nevojiten në forcimin e kontrolleve gjatë procesimit të lëndëve për pagesë (nuk janë respektuar hapat e përcaktuar me rregulla të thesarit si dhe kishte vonesa të konsiderueshme në realizimin e pagesave), si dhe raportimi i obligimeve.

3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore të MPB-së, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike si dhe të hyrat e arkëtuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final1	2015 Realizimi	2014 Realizimi	2013 Realizimi
Burimet e Fondeve:	**115,293,184**	**111,555,955**	**110,171,541**	**99,575,765**	**92,174,889**
Granti i Qeverisë -Buxheti	114,402,055	110,324,355	108,994,018	98,537,898	91,968,009
Të bartura nga viti paraprak[2]		328,372	327,520	469,348	-
Të hyrat vetjake[3]	891,129	891,129	848,800	562,757	206,880
Donacionet jashtme		12,099	1,203	5,762	

Buxheti final është më i ulët se buxheti fillestar për 3,737,229€. Reduktimi ishte si rrjedhojë e shkurtimit të buxhetit, në pajtim me vendimet e Qeverisë. Në vitin 2015, MPB ka përdorur afro 99% të buxhet final ose 110,171,541€, me një përmirësim prej 4% krahasuar me vitin 2014. Realizimi i buxhetit ishte bërë në nivel të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Realizimi	2014 Realizimi	2013 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	**115,293,184**	**111,555,955**	**110,171,541**	**99,575,765**	**92,174,889**
Pagat dhe Mëditjet	73,704,300	72,311,794	72,310,539	65,426,355	55,462,157
Mallrat dhe Shërbimet	21,324,469	22,994,075	21,798,547	19,656,660	21,975,792
Shërbimet komunale	1,878,180	1,786,661	1,686,099	1,559,003	1,539,043
Subvencionet dhe Transferet	1,318,870	2,646,560	2,600,735	900,249	997,362
Investimet Kapitale	17,067,365	11,816,865	11,775,620	12,033,498	12,200,535

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Në raport me buxhetin fillestar, buxheti final për kategorinë e investimeve kapitale është reduktuar për 5,250,500€. Fillimisht, me rishikim të buxhetit ishte reduktuar për 217,000€, ndërsa më pas me vendime të Qeverisë është reduktuar edhe për 5,033,500€;

[1] Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.
[2] Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.
[3] Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

- Te mallrat dhe shërbimet buxheti final ishte rritur për 1,669,606€. Fillimisht me rishikim të buxhetit ishte reduktuar për 1,387,904€, mirëpo më pas me vendime të Qeverisë buxheti në këtë kategori ishte rritë për 3,057,510€;
- Buxheti për kategorinë e komunaleve ishte reduktuar për 91,519€. Reduktimi ishte bërë si rezultat i transferimit të kësaj vlerë në kategoritë tjera të shpenzimeve;
- Buxheti fillestar për Subvencione dhe Transfere ishte rritë 1,327,690€. Me rishikim të buxhetit ishte rritur në vlerë 200,000€, me pastaj me vendim të Qeverisë është rritë edhe për 1,127,690€; dhe
- Buxheti për paga dhe mëditje ishte reduktuar për 1,392,506€. Fillimisht më rishikim të buxhetit ishte reduktuar për 1,832,399€, mirëpo më pas më vendimet Qeverisë ishte rritë për 439,893€.

Tabela 3. Të hyrat vetjake për buxhetin e MPB-se – ekzekutimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Pranimet	2014 Pranimet	2013 Pranimet
Të hyrat	-		43,201,460	45,790,159	38,959,468
Rreziku Totali	-	43,201,460	43,201,460	45,790,159	38,959,468

Nga gjithsej të hyrat vetjake, vetëm 1,176,320€ ishin lejuar të shpenzoheshin për nevojat e MPB-së, ndërsa pjesa ishin transferuar në Buxhetin e Kosovës (BK).

Në raport më vitin 2014 të hyrat vetanake kishin pësuar rënie prej 2,588,699€. Kjo rënie ishte rrjedhojë e rënies së të hyrave nga gjobat, pas vendimit për mos konfiskimin e dokumenteve të qarkullimit.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.4 Prokurimi

Rregullat e prokurimit kanë për qëllim për të siguruar që fondet publike të arrijnë vlerën për para përmes aplikimit transparent dhe efikas. Korniza ligjore i përcakton qartë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në prokurimin publik. Kjo përfshin kërkesat për t`i pakësuar rreziqet në lidhje me vonesat në përfundimin e punëve, realizimin e kontratave sipas kushteve të parapara, shmangien e konfliktit të interesit dhe arritjen e vlerës për para.

Ne gjatë auditimit kemi rishikuar procesin e blerjeve përmes prokurimit për të vlerësuar nëse MPB dhe agjencitë e saj kanë zbatuar procedurat dhe i janë përmbajtur dispozitave të ligjit të prokurimit publik. Në kuadër të investimeve kapitale ne kemi rishikuar edhe Programin për Investime Publike (PIP) dhe në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, për të verifikuar nëse kanë qenë të përfshira të gjitha projektet kapitale. Analiza jonë ka përfshirë edhe ndryshimet lidhur me projektet e planifikuara.

Testet tona shpalosen mangësitë të cilat i kemi prezantuar në vijim.

Dobësitë sistematike të prokurimit

Çështja 3 – Shmangia nga procedurat e hapura të tenderimit - Prioritet i mesëm

E gjetura

Për mirëmbajtën dhe servisimin e automjeteve, PK i kishte 19 kontrata aktive përmes procedurës së hapur të prokurimit (marrë parasysh shumëllojshmërinë e automjeteve). Mirëpo edhe përpos kësaj gjatë vitit 2015, kishte lidhë edhe 15 kontrata tjera përmes procedurës së koutimit të çmimit në vlerë 35,695€.

Përdorimin e procedurës së kuotimit të çmimeve, zyrtarët përgjegjës e kanë arsyetuar me shumëllojshmërinë e veturave të cilat i posedon PK-ja dhe nevojën për servisimin e shpejtë të tyre. Megjithëse, sipas vlerësimit tonë kjo kishte rrjedh si pasojë e planifikimit të dobët.

Rreziku

Prania e dukurive të tilla gjatë përzgjedhjes së procedurave të prokurimit mund të dëmtojnë konkurrencën dhe të vejnë në pikëpyetje cilësinë e shërbimeve apo produkteve të pranuara për paranë e dhënë.

Rekomandimi 3

Ministri në bashkëpunim më Drejtorin e Përgjithshëm të PK-së duhet të sigurojnë se Departamenti i prokurimit ka bërë një analizë të mirëfilltë para procesit të planifikimit në mënyrë që kërkesat për shërbimet e njëjta të tenderohen përmes procedurave të kontratave kornizë. Kjo njëkohësisht do të shmang edhe kërkesat e shumta administrative që kanë të bëjnë më lidhjen e disa kontratave më kuotim të çmimeve.

Çështja 4 - Procesimi i urdhërblerjeve pas pranimit të faturës - Prioritet i mesëm

E gjetura Neni 22 i rregullës financiare nr. 01/2013/MF, përcakton procedurat e përgjithshme për procesimin e pagesave. Fillimisht behet kërkesa për blerje, urdhërblerja, raporti i pranimit e më pas fatura.

Nga 41 pagesa/mostra të testuara, në 11 pagesa (tre në MPB, dy në IPK, tre në PK dhe tre në ASPK) kemi hasur në urdhër blerje të cilat janë procesuar pas pranimit të faturës.

Zyrtarët e financave, gjatë procesimit të lëndëve për pagesë, kanë dështuar të ndjekin të gjithë hapat e përcaktuara më rregulla të thesarit. Në anën tjetër zyrtaret çertifikues nuk kanë arritur të parandalojnë këtë dukuri.

Rreziku Kryerja e pagesave para se të përcaktohen kërkesat/nevojat, mund të rezultojë që të pranohen mallra të cilësisë dhe sasisë jo të nevojshme.

Rekomandimi 4 Ministri dhe Drejtorët Ekzekutiv duhet të sigurojnë se kontrollet në procesin e ekzekutimit të pagesave janë duke u monitoruar në vazhdimësi. Procesi i pagesave duhet të bëhet në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar me LMFPP-në, dhe me rregullat e Thesarit.

Çështja 5 - Vonesat në realizimin e projekteve - Prioritet i mesëm

E gjetura Si pasojë e mos identifikimit të rreziqeve me kohë, realizimi i projekteve kapitale po përcillet me vonesa të njëjta vit pas viti. Në vijim kemi shpalosur tri raste si:

- Në kontratën "Ndërtimi i Depos për Ruajtjen e Materialeve të Rrezikshme në Kampin e Vrellës në PK" e nënshkruar më datë 04 qershor 2015 në vlerë 29,928€, afati për përmbushjen e kontratës ishte 30 ditë kalendarike. Edhe përkundër shumë ditëve të arsyetuara nga Autoriteti Kontraktues (AK), OE ishte vonuar në përmbushjen e kontratës. Kontrata ishte përfunduar më 19 nëntor 2015, me 137 ditë vonesë;

- Në kontratën "Furnizimi dhe Vendosja e Dyerve me Senzor dhe Rregullimi i Shkalleve Emergjente në Objektin e Administratës së PK-së" e nënshkruar e me datë 22 prill 2015 në vlerë prej 9,182€, afati për përfundimin e punëve ishte 25 ditë kalendarike. Ky projekt ishte përfunduar me datë 09 qershor 2015, me 22 ditë vonesë; dhe

- Te kontrata“ Renovimi i Sallës në Drejtorinë Regjionale Ferizaj të PK-së” në vlerë prej 25,370€, e nënshkruar me datë 08 tetor 2014, afati kohor për përfundimin e kontratës ishte 75 ditë kalendarike. Kjo kontratë ishte përfunduar më datë 16 prill 2015, përkatësisht me 115 ditë vonesë.

Sipas zyrtareve të PK-së, afati i paraparë në kontratë ka qenë i pamundur të realizohet për shkak të verifikimit të punëtoreve, ditëve të vikendit, zbatimit të ligjit të punës, sezonës së dimrit, verifikimi i materialeve nga Autoriteti kontraktues, etj. Bazuar në këtë PK kishte arsyetuar shumë ditë të punës. Për ditët e pa arsyetuara lidhur më vonesat në realizimin e kontratave, PK kishte aplikuar ndëshkimet.

Megjithatë secili autoritet kontraktues, gjatë procesit të planifikimit duhet të marrë parasysh edhe pengesat me të cilat mund të ballafaqohet gjatë realizimit.

Rreziku Dështimi për t’i përfunduar më kohë projektet e përcaktuara mund ta reduktojë efektivitetin e operacioneve të PK-së dhe do të rezultojë në dështim të arritjes së objektivave. Vonesat në realizimin e projekteve gjithashtu mund të rezultojnë në rritjen e obligimeve në fund të vitit, të cilat do të jenë barrë për buxhetin e vitit vijues.

Rekomandimi 5 Ministri në bashkëpunim më Drejtorin e Përgjithshëm të PK-së duhet të sigurojnë se janë forcuar edhe me tej kontrollet në proceset e planifikimit (analizë e pengesave të mundshme), monitorimit dhe realizimit të projekteve kapitale, në mënyrë që të respektohet afati për përmbushjen e kontratës.

Çështja 6 - Vonesa në ekzekutimin e pagesave – Prioritet i mesëm

E gjetura

Neni 37 pika 1 e Rregullës Financiare Nr.01/2013/MF – përcakton se "të gjitha faturat që i pranon organizata buxhetore duhet të paguhen brenda 30 ditëve në qoftë se nuk është paraparë ndryshe me kontratë".

PK nuk ka arritur të kryejë pagesat në afatin e përcaktuar ligjor. Në pesë raste të testimeve, pagesat nuk janë realizuar brenda afatit ligjor. Në njërin nga këto raste, te pagesa për furnizim me vaj të automjeteve në vlerë 24,999€, pas kalimit të afatit ligjor të pagesës, Operatori Ekonomik (OE) kishte shfrytëzuar të drejtën për kërkesë në bazë të LMFP neni 39.2 duke pranuar pagesën direkt nga thesari.

Arsyeja e vonesave kryesisht ishte si rrjedhojë e mos protokollimit të faturave[4]. Mirëpo pas kështillave tona në fazën e ndërmjetme të auditimit, menaxhmenti kishte filluar të mbaj librin e protokollit.

Rreziku

Vonesat në ekzekutimin e pagesave rrisin rrezikun për pagesa shtesë të dëmshpërblimeve ndaj OE. Kjo rrit rrezikun e dështimit të pagesave për mungesë të fondeve dhe bartjen e obligimeve në vitin pasues.

Rekomandimi 6

Ministri në bashkëpunim më Drejtorin e Përgjithshëm të PK-së duhet të sigurojnë mbikëqyrje të rregullt të procesit të realizimit të buxhetit, me qëllim që çdo faturë të paguhet brenda afatit të përcaktuar ligjor.

[4]Rregulla Financiare NR.01/2013/MF – Neni 24 Pranimi dhe pagesa e faturës pika 1.3 përcakton që fatura të protokollohet dhe të evidentohet në librin e faturave.

Dobësitë jo-sistematike të prokurimit

Çështja 7 - Çertifikim jo i rregullt i pagesës - Prioritet i mesëm

E gjetura

Kontrata "Mirëmbajtja Higjienike dhe Bartja e Inventarit të PK-së" ishte e lidhur në bazë të hapësirave bazuar në m2. Gjatë testimit të pagesës në vlerë 6,615€ vërejtëm se për muajin shtator (për pozicionin pastrim i hapësirave të brendshme) ishin faturuar më shumë hapësira , në m2 në raport më hapësirat e parapara në kontratë.

OE gjatë punës në teren kishte vërejtur se hapësirat fizike të objekteve për mirëmbajtje ishin më të mëdha në raport më ato të kontraktuara. Si rezultat i kësaj ata ishin ankuar të PK-ja, të cilët më pas kishte bërë matjen e objekteve dhe kishte verifikuar që ankesa e OE ishte e drejtë (hapësirat e objekteve ishin më të mëdha se sa ato të përcaktuara në projekt/dosje të tenderit dhe në kontratë).

Pagesa e bërë për këto lëvizje të bëra në hapësirat e objekteve bazuar në m2 nuk ishte vërejtur nga zyrtari çertifikues gjatë procesit të çertifikimit.

Rreziku

Si rezultat i planifikimit të dobët PK mund rrezikojë që vlera e faturave për pagesë të jetë me e lartë se sa vlera e planifikuar për këtë qëllim.

Rekomandimi 7

Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm të PK-së, duhet të sigurojnë kontrolle shtesë te njësitë kërkuese, në mënyrë që kërkesat të jenë të strukturuara mirë (të qarta dhe të sakta). Gjithashtu duhet të sigurojë se Zyrtari Çertifikues si funksion kyç i sistemit të kontrollit, të kontrolloj të gjitha pagesat për të verifikuar nëse ato janë në pajtim më kontratat.

3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit

Në kategorinë e shpenzimeve tjera për të cilat nuk nevojitet të zhvillohen procedura të prokurimit, ne testuam disa mostra përfshirë shpenzimet për paga (kontrata për shërbime të veçanta) të cilat janë paguar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve. Testet tona shpalosen çështjen si në vijim:

Çështja 8 – Pagesat e pagave nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve – Prioritet i lartë

E gjetura

Neni 33 i rregullës financiare 01/2013 thekson se organizata buxhetore duhet të sigurojnë që të gjithë personat në marrëdhënie pune të paguhen përmes listës së pagave. Me tutje neni 12 i ligjit për shërbyesit civil citon "Emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë muaj do të bëhen në bazë të kontratave të quajtura "Marrëveshje për shërbime të veçanta" të cilat i nënshtrohen Ligjit për Detyrimet dhe për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit.

Në raportin e auditimit të vitit 2014 ne rekomanduam që mos të përsëritet praktika e financimit të pagave të të punësuarve me kontrata për shërbime të veçanta nga buxheti për mallra dhe shërbime. Me tutje, në buxhetin e viteve në vijim në kategorinë paga dhe mëditje duhet të përfshihen pagat e të gjithë të punësuarve të nevojshëm në organizatë, si dhe të gjitha pagesat për paga të kalojnë përmes sistemit të pagave.

Mirëpo edhe përkundër zotimit të menaxhmentit për ta adresuar këtë çështje, ata gjatë vitit 2015 kishin lidhur pesë kontrata "Marrëveshje për Shërbime të Veçanta" pa asnjë procedurë paraprake të rekrutimit. Këta punonjës janë paguar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve në vlerë 9,883€. Megjithëse, në raport më vitin 2014 numri i kontratave të tilla është reduktuar dukshëm.

Rreziku

Praktika e lidhjes së kontratave të përkohshme, pa procedura të rekrutimit, shton rrezikun për përzgjedhjen e kandidatëve pa shkathtësitë dhe përvojat e duhura profesionale. Ndërsa, numri më i lartë i të punësuarve aktual në raport më numrin e të punësuarve të paraparë më buxhet mund të shkaktoj kosto shtesë për shërbimet e ofruara.

Rekomandimi 8

Ministri në bashkëpunim më Sekretarin e Përgjithshëm duhet të sigurojnë se janë marrë masa për të ndërprerë praktikën e lidhjes së kontratave pa procedura të rekrutimit, si dhe të sigurojnë se në buxhetin e viteve në vijim në kategorinë paga dhe mëditje përfshihen pagat e të gjithë të punësuarve të nevojshëm, si dhe të gjitha pagesat për pagat e tyre të kalojnë përmes sistemit të pagave.

3.5.1 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollet që operojnë në nivel të MPB-së kanë të bëjnë me kontrollin e pagesave çdo muaj duke i nënshkruar listat e pagave, verifikimin e ndryshimeve të mundshme, rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me Thesarin.

Ne kemi rishikuar listat e pagave si dhe kemi krahasuar të dhënat e prezantuara nga Thesari, SIMFK dhe prezantimin e tyre në PVF. Po ashtu kemi testuar disa mostra, duke përfshirë dosjet e personelit dhe procedurat e rekrutimit të realizuara në këtë periudhë, procesin e pensionimeve, pushimet e lehonisë etj.

Bazuar në këtë, ne kemi shpalosur mangësitë si në vijim.

Çështja 9 - Mbulimi i pozitave me ushtrues detyre - Prioritetet i lartë

E gjetura

Neni 30 pika 4 i Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës thekson se në rast të mbetjes së një pozite të lirë në shërbimin civil, Ushtruesi i Detyrës (UD) nuk mund të emërohet më gjatë se tre muaj. Ndërsa, Neni 39 i Udhëzimit administrativ nr. 07/2012 mbi marrëdhënien e punës në PK e përcakton periudhën kohore ku UD mund të caktohet, në kohëzgjatje deri në gjashtë muaj me mundësi vazhdimi edhe për tre muaj tjerë.

Me gjithë përpjekjet e menaxhmentit për implementimin e rekomandimit të dhëne në raportin e vitit të kaluar, ende numri i pozitave me UD është i lartë. Në MPB edhe më tej vazhdojnë të mbulohen 19 pozita me UD, ndërsa PK në fund të vitit ishin 24 pozita.

Në raport më vitin 2014 PK ka reduktuar dukshëm numrin e pozitave me UD (nga 48 në vitin 2014 në 24 në fund të vitit 2015, ndërsa në prill të vitit 2016 kishin mbetur vetëm gjashtë pozita me UD). Ndërsa në MPB përkundrazi është rritur numri i UD-ve (nga 15 në vitin 2014 në 19 në vitin 2015).

Zyrtarët përgjegjës të MPB-së theksojnë se pozitat më UD janë rrjedhojë e vonesave të aprovimit të rregullores nga MAP-i për sistematizimin e vendeve të punës, si dhe mosfunksionimit të sistemit elektronik te menaxhimit të burimeve njerëzore (SIMBNJ), ndërsa PK thekson se UD-të janë si rrjedhojë e lëvizjeve të stafit.

Rreziku Praktika e mbulimit për një kohë të gjatë të pozitave kyçe me UD rrezikon që pozitat të menaxhohen nga personat që nuk i përmbushin kriteret e nevojshme. Më tej pagesat të cilat nuk janë në pajtim më Legjislacionin mund të konsiderohen të parregullta.

Rekomandimi 9 Ministri në bashkëpunim më Drejtorin e Përgjithshëm të PK-së duhet të rishikojnë arsyet për mos adresimin e rekomandimeve të AP-së dhe të përcaktoj kontrolle shtese në menaxhimin e procedurave të rekrutimit. Procedurat e rekrutimit duhet të fillojnë me kohë, dhe kohëzgjatja e funksionit si ushtrues detyre të mos jetë më e gjatë se periudha e përcaktuar më Udhëzimin Administrativ.

Çështja 10 - Pagesa e pagës në kundërshtim me vendimin e Qeverisë – Prioritet i mesëm

E gjetura Sipas vendimit për plotësimin e vendimit të Qeverisë nr. 7/135 të datës 01 mars 2005, Zëvendës Ministrave të Qeverisë së Kosovës u njihet e drejta e 70%-shit të vlerës së pagës bazë për një vit mbas mbarimit të mandatit. Të drejtë në këtë pagë kanë ish Zëvendës Ministrat të cilët nuk marrin të ardhura nga Buxheti i Kosovës.

Për njërin nga ish Zëvendës Ministrat e MPB-së ne kemi vërejtur se kishte pranuar edhe pagesën nga Zyra e Kuvendit Komunal - Gjilan për kohën e njëjtë kur ka marrë pagesë nga MPB-ja bazuar në vendimin e Qeverisë[5].

Zyrtarët përgjegjës për procesimin e pagave në MPB nuk kanë pas informacione se ish Zëvendës Ministri në fjalë pranon edhe të ardhura tjera nga Buxheti i Kosovës.

Rreziku Kontrolli jo i mirë i shpenzimeve, rrit rrezikun e realizimit të pagesave të parregullta, të cilat ndikojnë në shpenzim jo të drejtë të buxhetit.

Rekomandimi 10 Ministri në bashkëpunim më Sekretarin e Përgjithshëm duhet të sigurojnë se janë parandaluar të gjitha pagesat të cilat janë në kundërshtim me vendimet e Qeverisë. Informatat lidhur më të ardhurat nga burimet tjera mund të merren nga zyrtarët e MF-së të cilat janë përgjegjës për menaxhimin e listës së pagave.

[5] Për vitin 2015 nga MPB ka pranuar vlerën prej 9,587€ page bruto, si dhe nga Zyra e Kuvendit Komunal Gjilan 2,450€.

Çështja 11 - Mirëmbajtje jo e mirë e dosjeve të personelit – Prioritet i mesëm

E gjetura Në raportin e auditimit për PVF-të e vitit 2014 ne rekomanduam PK-në që të strukturojnë dhe të kompletojnë dosjet e personelit duke i siguruar stafit kontrata valide dhe vlerësim të performancës. Këto çështje janë të rregulluara me UA 07/2012 mbi marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës neni 79[6].

Megjithatë edhe përkundër zotimit të menaxhmentit, ky rekomandim ende nuk është adresuar. Nga 23 dosjet e testuara vërejtëm se në asnjë rast nuk ishte bërë vlerësimi i përformancës për të punësuarit në PK, ndërsa në dy raste mungonin edhe kontratat e punës.

Rreziku Pagesat e pagave në mungesë të kontratave mund të konsiderohen të parregullta. Ndërsa, moskryerja e vlerësimit të punës për të punësuarit me kohë, mund të ketë efekt negativ në përformancën e mëtutjeshme të punëtorëve në organizatë. Kjo pamundëson identifikimin e fushave për përmirësim dhe zhvillimin e tyre në mënyrë më efektive.

Rekomandimi 11 Ministri në bashkëpunim më Drejtorin e Përgjithshëm të PK-së duhet të shqyrtojnë shkaqet e mos adresimit të këtij rekomandimi në vazhdimësi dhe të përcaktojnë kontrolle shtesë në menaxhimin e Burimeve Njerëzore për të siguruar azhurnim të rregullt të dosjeve të personelit, si dhe vlerësim të rregullt vjetor për të gjithë të punësuarit.

3.5.2 Subvencionet dhe Transferet

Shpenzimet për kategorinë Subvencione dhe Transfere për 2015, ishin në vlerë prej 2,600,735€.

Subvencionet në kuadër të MPB-së janë subvencione për personat e riatdhesuar të cilët i kanë përfituar subvencionet për financimin e planit të biznesit sipas rregullores QRK 20/2013 për ri-integrimin e personave të riatdhesuar dhe menaxhimin e programit të ri-integrimit.

Gjate testimit te raporteve të monitorimit lidhur me implementim e planeve të biznesit ne kemi identifikuar çështjen si në vijim.

[6] Sipas Udhëzimit Administrativ 07/2012 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës neni 79 pika 2 dhe 4, mbikëqyrësit janë të obliguar që së paku një herë në vit të bëjnë vlerësimin e përformancës së punonjësve, dhe atë në fund vit. Rezultatet duhet të vendosen në dosjen personale të personelit me qëllim që të merren parasysh gjatë avancimit, gradimit dhe procedurave disiplinore.

Çështja 12 -Dobësitë e identifikuara në Subvencione - Prioritet i mesëm

E gjetura

Sipas Rregullores QRK 20/2013 për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Menaxhimin e Programit të Ri-integrimit, personat e riatdhesuar të moshës madhore mund të përfitojnë nga ndihma për financimin e projekteve për gjenerimin e të hyrave vetanake - plan bizneseve me qëllim të ri-integrimit të qëndrueshëm. Megjithatë sipas kësaj rregullore përcaktohen edhe kriteret për përfitimin e tyre. Neni 17, pika 5 citon "Personi i riatdhesuar është i obliguar që mjetet t'i shfrytëzoj për realizimin e planit të aprovuar të biznesit".

Sipas raporteve të monitorimit nga tereni lidhur me implementimin e planeve të biznesit dhe sipas raporteve nga zyra e Departamentit për Ri- integrimin e Personave te Riatdhesuar është vërejtur se nuk ishte monitoruar mjaftueshëm realizimi i tyre. Nga katër lëndët e testuara (secili në vlerë 2,000€), në një rast biznesi ishte në proces të themelimit, ndërsa në tri rastet tjera bizneset nuk ishin funksionale. Në vijim kemi shpalosur detajet për secilin rast:

- Përfituesi nuk e ka hapur biznesin për të cilin edhe e ka përfituar subvencionin;
- Përfituesi e ka hapur biznesin për tre muaj, mirëpo për shkak që nuk kishte arritur të realizoj të hyra të mjaftueshme, ai ka shitur pajisjet dhe ka mbyllur biznesin;
- Përfituesi ka migruar dhe biznesin për të cilin edhe e ka përfituar subvencionin nuk e kishte funksionalizuar; dhe
- Përfituesi ende nuk ka hapur biznesin, mirëpo shpreson se së shpejti do ta do ta finalizoj këtë proces. Deri në fund të vitit pothuajse gjysmën e mjeteve i kishte shpenzuar.

Rastet e lartcekura tregojnë se dhënia e subvencioneve për personat e riatdhesuar nuk ishte monitoruar mjaftueshëm dhe si pasojë kanë munguar rezultatet në këtë drejtim.

Rreziku

Anashkalimi i procedurave të subvencionimit dhe udhëzuesve përkatës mund të rezultojë me pagesa potencialisht të parregullta dhe të pambështetura. Mos arsyetimi dhe mos raportimi për projektet e subvencionuara, shkaktojnë menaxhim të dobët buxhetor dhe mund të shkaktoj përdorimin e fondeve në kundërshtim me synimet e planifikuara.

Rekomandimi 12 Ministri duhet të shqyrtoj rastet e lartpërmendura për t'i hetuar shkaqet e mos realizimit të objektivave dhe të sigurojë se kontrolle shtesë në këtë drejtim. Përkrahja financiare e projekteve duhet të përcillet përmes procedurave përkatëse të monitorimit për të siguruar se janë realizuar objektivat e shpenzimeve në këtë kategori.

3.6 Të Hyrat (përfshirë të hyrat vetjake)

Të hyrat e realizuara nga MPB dhe agjencitë e saj në 2015 ishin në vlerë 43,200,257€.

MPB dhe Agjencitë e saj kishin një mori kontrollesh lidhur me mbledhjen dhe raportimin e të hyrave, përfshirë edhe prezantimin e tyre në PVF. Bazuar në këtë në vijmë në përfundim se të hyrat janë inkasuar dhe raportuar në pajtueshmëri me legjislacionin.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.7 Pasuritë dhe detyrimet

3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Menaxhimi i pasurisë është një pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik. Kjo kërkon procedura të kontrollit dhe menaxhimit të cilat vërtetojnë ekzistencën e pasurive/ dhe sigurojnë të dhëna të azhurnuara në përputhje me pasuritë e reja dhe ndryshimet e tjera.

Pasuritë neto të MPB-së dhe Agjencive ekzekutive ishte 56,635,219€. Prej tyre 50,473,143€ ishin pasuritë më vlerë mbi 1,000€, 5,520,783€ pasuritë nën vlerën 1,000€, ndërsa stoqet në fund të vitit 641,293€.

Ne kemi testuar pasuritë që rrjedhin nga investimet kapitale gjatë vitit 2015, si dhe rregullsinë në evidentimin e pasurisë në dispozicion, përfshirë edhe pasuritë e dhuruara si donacion. Ne kemi bërë edhe ekzaminimin fizik për të verifikuar ekzistencën e pasurisë.

Bazuar në këtë kemi identifikuar mangësitë si në vijim.

Çështja 13 – Pritjet e gjata te automjeteve që presin për servisim - Prioritet i lartë

E gjetura Edhe përkundër zotimit të menaxhmentit për të adresuar rekomandimin rreth riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve, edhe më tutje në autoparkun e Flotës së Policisë janë 131 automjete, ose rreth 10% e automjeteve të PK-së, që presin për riparim qysh nga viti 2012 e tutje.

Pritjet e gjata janë si rrjedhojë e mungesës së mjeteve rezerve, numrit të vogël të stafit në këtë shërbim, si dhe vjetërsia e automjeteve.

Rreziku Pritjet e gjata të automjeteve mund t'i ekspozohen rrezikut edhe për keqpërdorimin ose humbjen e pjesëve të tyre.

Rekomandimi 13 Ministri në bashkëpunim më Drejtorin e Përgjithshëm të PK-së duhet të rishikojnë arsyet për mos adresimin e rekomandimeve të AP-së dhe të përcaktojnë masa shtesë për të forcuar kontrollet në këtë njësi. Kontrollet duhet të përfshijnë gjithë procesin prej identifikimit të defekteve e deri te riparimi i tyre. Kjo do të eliminonte pritjet e gjata të automjeteve dhe do të siguroj shfrytëzim me efikas të tyre.

Çështja 14 – Dobësi në menaxhimin e pasurive (në depo) - Prioritet i mesëm

E gjetura

MPB nuk kishte menaxhim të mirë të stoqeve. Në disa raste blerjet nuk kishin hyrë në përdorim me vite të tëra, madje disa deri në kohën e zhvlerësimit të plotë të tyre. Sipas pasqyrave financiare të stoqeve në depo të PK-së, kemi vërejtur se pasuritë (mbi 1,000€) në vlerë 58,773€ që figuronin në regjistrin e depos ishin zhvlerësuar tërësisht. Kjo përfshinte pajisjet e blera qysh në vitin 2006 e tutje (pajisje elektronike në vlerë 3,842€, pajisje të IT-së" 40,081€ pajisje të policisë dhe pajisje të tjera 14,850€).

Me tutje, automjetet e transportit të pranuara si donacione (kamionë dhe automjete të përdorura), nga viti 2010 deri 2014, ende figuronin në pasqyrat financiare të PK-së si stoqe. Këto mjete edhe fizikisht ende nuk ishin vënë në qarkullim (Kamion për ngarkesa të rënda në vlerë 16,000€, Kamion Man në vlerë 3x3,000€ = 9,000€, Nissan Terrano në vlerë 5x 3,500€ =10,500€, Kombi HYUNDAI H100 në vlerë 1,500€ dhe Kamion në vlerë 2x5,000€ =10,000€.

Mangësi në menaxhimin e depos identifikuam edhe të IPK-ja. Fatura dhe fletëpranimi i mallit në vlerë 2,735€, lidhur me kontratën "Furnizim me tonerë në Inspektoratin Policor" nuk korrespondonte me raportin e daljes se mallrave dhe stokut së IPK-së. Gjithashtu mallrat e pranuara (sasi 100* 29€) lidhur më pagesën në vlerë 2,900€, për kontratën "Furnizim me Dikstiktivë në IPK "nuk ishin regjistruar në sistemin E-pasuria.

PK kishte marrë masa të menjëhershme për adresimin e kështillës tonë të dhëne në memorandumin e auditimit të dorëzuar në muajin dhjetor 2015. Ata kanë azhurnuar listën e stoqeve si dhe kanë formuar komisionin për vlerësimin e automjeteve të pranuara si donacion. Kamionët të cilët janë vlerësuar si funksionale për punë janë futur në përdorim, ndërsa automjetet e aksidentuara është marrë vendim të shfrytëzohen për pjesë rezerve. Gjithashtu edhe IPK në fund të vitit e ka adresuar këshillën e dhënë.

Rreziku

Në mungesë të evidencave të plota menaxhmenti nuk ka të dhëna të sakta mbi pasurinë, andaj ekziston rreziku i vendimmarrjes së gabuar por edhe i keqpërdorimit të tyre.

Rekomandimi 14

Ministri në bashkëpunim më Drejtoret e Agjencive (PK dhe IPK) duhet të sigurojnë kontrolle funksionale në menaxhimin e pasurisë për të mundësuar azhurnimin e rregullt të regjistrave të tyre, përfshirë edhe procesin e inventarizimit (krahasimi i regjistrave të pasurisë me gjendjen e tyre fizike). Ndërsa për pasuritë e përdorura të pranuara si donacion, duhet të behët një komision për të vlerësuar gjendjen e tyre dhe bazuar në konkluzionin e nxjerrë nga komisioni, menaxhmenti të merr vendim për formën e përdorimit të tyre.

Çështja 15 - Vonesa në inventarizimin e pasurisë - Prioritet i mesëm

E gjetura

Sipas rregullores MF Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare, përcaktohet qëllimi i procesit të inventarizimit, përgjegjësitë e organizatave lidhur më këtë proces si dhe raportimi i tyre[7].

PK nuk ka arritur të përfundojë procesin e inventarizimit me kohë, përkatësisht para përgatitjes së pasqyrave financiare.

Komisioni për inventarizim të pasurisë në kuadër të PK-së ishte formuar me datë 27 tetor 2015, mirëpo për arsye të refuzimit të punës nga kryetari i komisionit, ky proces ishte anuluar (rasti është në procedurë disiplinore). Ndërsa vendimi tjetër për themelimin e komisionit të inventarizimit të përbërë nga 10 ekipe është nxjerrë me datën 26 shkurt 2016. Komisioni ka filluar procesin e inventarizimit, mirëpo deri më datë 04 prill 2016 sa ishim në fazën e ekzekutimit të terenit, ky proces nuk kishte përfunduar (nuk ishte dorëzuar raporti përfundimtar).

Rreziku

Mungesa e inventarizimit të pasurisë rrit rrezikun e mos evidentimit të saktësisë, cilësisë dhe gjendjes fizike të pasurive jo financiare në PVF.

Rekomandimi 15

Ministri në bashkëpunim më Drejtorin e Përgjithshëm të PK-së duhet të sigurojnë se procesi i inventarizimit të pasurisë është përfunduar dhe raportuar në kohë të përshtatshme para përgatitjes së PVF-ve. Të gjitha ndryshimet e identifikuara nga ky proces përfshirë vlerën dhe numrin e pasurisë të prezantohen në regjistrat e pasurisë (regjistrin kontabël dhe sistemin E-Pasuria).

[7] Neni 18, pika 1. dhe 3. Inventarizimi bëhet me qëllim të vërtetimit të saktësisë, cilësisë dhe gjendjes fizike të pasurisë jo financiare. Organizatat buxhetore duhet të kontrollojnë së paku njëherë në vit pasurinë jo financiare për të vërtetuar dhe vlerësuar gjendjen faktike të pasurisë jo financiare. Neni 19. Pika 4.7. Hartimi i raportit të përgjithshëm në bazë të raporteve individuale të Komisionit për Inventarizimin e Pasurisë jo Financiare në kohën e përshtatshme para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore. Raporti i inventarizimit duhet të përmbajë gjendjen fizike të pasurisë jo financiare, kushtet e ruajtjes së tyre dhe vërejtjet mbi karakterin e diferencave dhe dëmtimeve të konstatuara.

Çështja 16 – Mos funksionalizim i sistemit e-pasuria - Prioritet i mesëm

E gjetura

Sipas rregullores MF Nr.02/2013, nenit 6, pika 3 citon "Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin e-pasuria". Në PK dhe AKSP nuk kishin përdorur këtë sistem, për regjistrimin e tyre ata kanë e kanë përdorur baza tjera të të dhënave.

Softueri i përdorur nga PK-ja për menaxhimin e pasurive kapitale dhe stoqeve ishte i besueshëm dhe ofronte raporte të plota dhe të sakta. Ndërsa AKSP, evidencat e pasurisë i mbante në një bazë të të dhënave në Excel. Pasuria neto përmbante gabime pasi që kishin probleme me normat e zhvlerësimit. Megjithatë diferencat nuk paraqesin vlera materiale.

APSK që nga viti 2003 kishte bërë kërkesë në Ministrinë e Administratës Publike (MAP) për implementimin e sistemit e-pasuria, por një gjë e tillë ende nuk ishte implementuar.

Rreziku

Informatat financiare të prezantuara në regjistra jo të besueshëm mund të mos përmbushin kërkesat e kontabilitetit dhe raportimit financiar. Kjo pamundëson një menaxhim efektiv dhe kontroll mbi pasuritë.

Rekomandimi 16

Ministri në bashkëpunim më Drejtorin e Përgjithshëm të AKSP duhet të sigurojnë se menaxhimi dhe raportimi i pasurisë bëhet në përputhje me kërkesat e dala nga rregullorja mbi menaxhimin e pasurisë. Lidhur më këtë duhet të vazhdojnë përpjekjet që ne bashkëpunim më MAP-in të funksionalizojnë sistemin e-pasuria.

3.7.2 Trajtimi i borxheve

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2015 ishte 593,054€.

Obligimet e papaguara të raportuara nga PK-ja ishin kryesisht për investimet kapitale, të cilat nuk ishin paguar si rrjedhojë e shkurtimit të buxhetit në këtë kategori nga MF-ja në fund të vitit.

Ne kemi testuar mënyrën e menaxhimit dhe raportimit të tyre, dhe bazuar në këtë kemi shpalosur mangësitë si në vijim.

Çështja 17 – Mos raportimi i rregullt i obligimeve të papaguara - Prioritet i mesëm

E gjetura

Sipas Rregullës financiare nr. 02/2013/MF Raportimi i obligimeve të papaguara citon: "Të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara që në Ministrinë e Financave - Thesar të raportojnë obligimet e tyre të papaguara. Raportimi, sipas kësaj rregulle financiare, bëhet përmes raporteve mujore".

MPB dhe PK, nuk kishin kontrolle të mjaftueshme në raportimin e obligimeve. Në katër lëndë të testuara dy në MPB dhe dy në PK vërejtëm se nuk ishin raportuar si obligime të papaguar në baza mujore. Vlera e përbashkët e tyre ishte 192,473€.

Pjesë e punës tonë ishte edhe testimi i disa mostrave nga raporti i obligimeve i prezantuar në PVF-të e vitit 2014, për të verifikuar nëse ato janë përcjellë rregullisht në raportet mujore të obligimeve në vitin 2015 deri në pagesën e tyre. Testet tona në këtë drejtim shpalosen dy parregullsi si:

- Obligimi në vlerë 45,504€, i cili nuk ishte paguar për shkak të ndërprerjes së njëanshme të kontratës më datë 24 prill 2015, nuk ishte prezantuar si obligim në raportin mujor për muajin shkurt dhe mars; dhe

- Obligimi në vlerë 999€, i paguar në muajin mars 2015, nuk ishte raportuar në raportin e obligimeve të muajit shkurt.

Gjithashtu, në 13 lëndë tjera të testuara vërejtëm së gjatë prezantimit të obligimeve nuk ishte bërë prerja e saktë e obligimeve.

Vlen të ceket që MPB dhe PK në fund të vitit 2015 kanë filluar implementimin e rekomandimit lidhur me raportimin e prerjeve mujore të obligimeve.

Rreziku

Mos raportimi i rregullt i obligimeve të papaguara rrit rrezikun që faturat të mos identifikohen dhe të mos paguhen me kohë. Njëkohësisht, ndaj Ministrisë mund të paraqiten ndëshkimet për vonesat në pagesë.

Rekomandimi 17

Ministri në bashkëpunim më Sekretarin e Përgjithshëm dhe Drejtorin e Përgjithshëm të PK-së duhet të sigurojnë kontrolle shtesë në menaxhimin e obligimeve. Vlerat e sakta të obligimeve duhet të përcillen nga një muaj në tjetrin, në përputhje me kërkesat ligjore. Për më tepër, të gjitha masat e nevojshme duhet të merren për forcimin e kontrolleve për këto procese.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinioni i auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinioni mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të implementuara	Të adresuara por jo te implementuara	Të pa adresuara
3 Rekomandimet e vitit paraprak	Ministri duhet të sigurojë se plani i veprimit përcakton qartë një afat kohor dhe stafin përgjegjës për adresimin e të gjitha rekomandimeve të AP-së, me fokus fillestar në fushat e rëndësisë më të madhe. Implementimi i këtij plani duhet të rishikohet nga menaxhmenti në baza të rregullta kohore.		Nga 11 rekomandimet e dhëna në raportin e auditimit për PVF-të e vitit 2014, tri rekomandime janë implementuar, gjashtë janë adresuar pjesërisht, ndërsa dy nuk ishin adresuar.	
4.2 Planifikimi dhe realizimi i Buxhetit	Ministri duhet të sigurojë se do të përcaktohen shkaqet e realizimit të ulët të buxhetit (vonesat në zhvillimin e procedurave, anulimet dhe vonesat në realizimin e projekteve). Duhet të rishikohen mundësitë për fillimin më të hershëm të procedurave të prokurimit, si dhe të monitorohet në baza të rregullta performanca buxhetore, më theks të veçantë të investimet kapitale.	Është implementuar.		
4.4.1 Prokurimi	Ministri duhet të sigurojë se kontrollet janë shtuar në mënyrë që kontrollet për kontratat të nënshkruhen vetëm atëherë kur ekzistojnë fonde që sigurojnë ekzekutimin e kontratës. Gjithashtu duhet të siguroj se janë forcuar kontrollet në procesin e ekzekutimit të pagesave. Procesi i pagesave duhet të bëhet në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar me LMFPP-në, dhe me rregullat e Thesarit.		Ky rekomandim është adresuar, mirëpo nuk është implementuar plotësisht. Nga 41 pagesa të testuara, në 11 prej tyre urdhër blerjet ishin procesuar pas pranimit të faturës.	

4.4.1 Prokurimi	Ministri duhet të siguroj kontrolle shtesë rreth aktiviteteve (sistemit) tëProkurimit. Kontratat më OE duhet të përfshijnë të gjitha kushtet e parapara në dosjen e tenderit.	Është implementuar.		
4.4.1 Prokurimi	Ministri duhet të sigurojë se janë forcuar kontrollet në realizimin e kontratave për projektet kapitale, duke siguruar monitorim dhe raportim të saktë brenda njësive operuese të saj.		Menaxhmenti e ka adresuar ketë çështje, mirëpo nuk është adresuar plotësisht. Edhe në vitin 2015 ishin vërejtur vonesa në realizimin e projekteve.	
4.4.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit	Ministri duhet të sigurojë se nuk do të përsëritet praktika e financimit të pagave të të punësuarve me kontrata për shërbime të veçanta nga buxheti për Mallra dhe Shërbime. Me tutje, në buxhetin e viteve në vijim në kategorinë paga dhe mëditje duhet të përfshihen pagat e të gjithë të punësuarve të nevojshëm në organizatë, si dhe të gjitha pagesat për paga të kalojnë përmes sistemit të pagave në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike (MAP).			Nuk është adresuar, edhe në vitin 2015 ishin pesë të punësuat më kontrata mbi vepër.
4.4.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Ministri duhet të rishikoj arsyet për mos adresimin e rekomandimeve të AP-së dhe të përcaktoj kontrolle shtese në menaxhimin e procedurave të rekrutimit. Procedurat e rekrutimit duhet të fillojnë me kohë, dhe kohëzgjatja e funksionit si ushtrues detyre të mos jetë më e gjatë se periudha e përcaktuar më Udhëzimin Administrativ.			Nuk është adresuar, edhe në vitin 2015 ekzistonte një numër i madh i pozitave më UD. Madje të MPB vetëm se ishte rritë numri i tyre.

4.4.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Ministri duhet të siguroj që Departamentet e Burimeve Njerëzore kanë azhurnuar të gjitha dosjet e personelit, si dhe të gjithë Zyrtarët Përgjegjës kanë kryer më kohë vlerësimet vjetore për të punësuarit. Në këtë mënyrë, krijohet baza për të shpërblyer të punësuarit më meritor, si dhe të identifikohen edhe fushat për përmirësim e cila mundëson hartimin e një programi për zhvillimin e mëtutjeshëm të stafit.		Rekomandimi është në proces të adresimit. Kontratat e punës po thuajse në të gjitha rastet janë vendosur në dosjet e personelit, mirëpo edhe më tutje vlerësimi i performancës së stafit nuk ishte bërë.	
4.5.1. Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Ministri duhet të sigurojë se janë rishikuar arsyet për mos adresimin e rekomandimeve të AP-së dhe të përcaktoj masa shtesë për të forcuar kontrollet në këtë njësi. Kontrollet duhet të përfshijnë gjithë procesin prej identifikimit të defekteve e deri te riparimi i tyre. Kjo do të eliminonte pritjet e gjata të automjeteve dhe do të siguroj shfrytëzim me efikas të tyre.		Rekomandimi është adresuara, mirëpo nuk është implementuar plotësisht. Nga 268 automjete sa ishin në pritje për sevisim në vitin 2014, ky numër ka renë në 131.	
4.5.1. Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Ministri duhet të siguroj kontrolle shtesë në menaxhimin e pasurisë të cilat mundësojnë azhurnimin e rregullt të regjistrave të tyre, përfshirë edhe procesin e inventarizimit (krahasimi i regjistrave të pasurisë me gjendjen e tyre fizike).	Është implementuar.		
4.5.2 Trajtimi i borxheve	Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmerr masa të nevojshme për të identifikuar shkaqet e mos raportimit të drejtë të obligimeve të papaguara, dhe të sigurojë se vlera e saktë e obligimeve përcjellët nga muaji paraprak në muajin vijues në pajtueshmëri me kërkesat ligjore.		Pas pranimit të raportit ishte adresuar kjo çështje. Megjithatë ne identifikuam disa raste në ishte bërë prerja e saktë e obligimeve në raportet mujore.	